



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:229723

Datë: 14.02.2024

Numri i dokumentit: 05330534

C.nr.127/18

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA NË VUSHTRRI – Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtari Izet Gërguri, me bashkëpunëtoren profesionale Diellza Zeqiri Latifi në çështjen juridike kontestimore të paditëses M.B nga Vushtrria, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokatura M... Sh.p.k. me av.N.S nga Prishtina, kundër të paditurës B... me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson F.K, me objekt kontesti kompensim dëmi, vlera e kontestit 37,216.80 €, të precizuar me parashtresën e dorëzuar në seancën e dt.01.02.2024, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor publik të mbajtur me datën 01.02.2024, jashtë seance, me datën 14.02.2024 e mori dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT e bazuar kërkesëpadia e paditëses M.B nga Vushtrria ashtu që DETYROHET e paditura B... me seli në Prishtinë, që paditëses në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material të shkakuar në aksidentin e komunikacionit të datës 07.01.2018 në magjistralen Prishtinë – Ferizaj, në km 15-të, t’ia paguaj dëmshpërblimin si në vijim:

Në emër të dëmit jo material

- Për dhimbje fizike shumë prej 4,000.00€
- Për frikën e pësuar shumë prej..... 4,000.00€
- Për shëmtim trupor shumë prej 4,000.00€
- Për zvogëlim të aktivitetit jetësor shumë prej 4,000.00€

Në emër të dëmit material

- Në emër të ndihmës dhe kujdesit të personit të tretë shumë prej 400.00€
- Në emër të ushqimit të përforcuar shumë prej..... 400.00€
- Në emër të rehabilitimit klimaterik shumë prej504.00€
- Në emër të shpenzimeve të mjekimit shumë prej 82.70€

- Në emër të kompensimit për rentën e arritur-zvogëlimit të aftësisë punuese, për periudhën nga data 07.01.2018 e deri me datën 31.01.2024, t’ia paguaj shumë prej 12,356.07€,
- Në emër të kompensimit për të ardhmen në formë të rentës mujore për 20% të zvogëlimit të aftësisë së përhershme punuese, prej datës 01.02.2024 e derisa të ekzistojnë kushtet ligjore, shumen prej nga 109.60€ në muaj, më së largu deri me datën 5 të çdo muaji vijues, e derisa të ekzistojnë kushtet ligjore.

Apo shumë e tërësishme për të gjitha format e dëmit (kerkesat e arritura) në lartësi prej 29,742.77€, me kamatë ligjore prej 12%, duke llogaritur nga data 28.02.2018 (data e paraqitjes

së kërkesës për kompensim tek e paditura) e deri në përmbushjen definitive të detyrimit si dhe shpenzimet e procedurës, ne shume prej 2,458.00€, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

II.REFUZOHET pjesa e kërkesëpadisë së paditëses M.B nga Vushtrria, mbi shumat e gjykata si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë në emër të dëmit jo material, për dhimbje fizike shumë prej 4,000€, për frikën e pësuar shumë prej 4,000.00€, në emër të zvogëlimit të aktivitetit jetësor shumë prej 9,000 €, për shëmtim trupor shumë prej 2,000.00 €, dhe në emër të dëmit material, shpenzimet e mjekimit në shumë prej 634.10€, si dhe për kompensimin e rehabilitimit klimaterik në shumë prej 6,496.00€.

A r s y e t i m

Paditësja M.B nga Vushtrria përmes të autorizuarit të saj av.N.S me datën 27.03.2018 ka ushtruar padi pranë kësaj gjykate, ndaj të paditurës B... me seli në Prishtinë, për kompensim dëmi material dhe jo material.

E njëjta ka theksuar në padi se me datën 07.01.2018 rreth orës 17:10 në magjistralen Prishtinë – Ferizaj është shkaktuar fatkeqësi komunikacioni, ku si pasagjere në automjetin nën A lëndime trupore ka pësuar tani paditësja M.B. Ka shtuar se deri te aksidenti ka ardhur kur vozitësi nën A, ishte duke lëvizur në magjistralen Prishtinë – Ferizaj dhe kur arrin në km e 15-të duke mos ia përshtatur shpejtësinë e lëvizjes kushteve dhe fushëpamjes së rrugës e humb kontrollin mbi automjetin dhe del nga rruga ku godet mbrojtësit e metalit dhe hip mbi ta, dhe pastaj kthehet në rrugë i rrotulluar në kulm dhe vazhdon deri në pozitën përfundimtare, ku me këtë rast shkaktohet aksidenti e për pasojë lëndime të shumta trupore pëson tani paditësja në cilësi të pasagjeres M.B, Në seancën e shqyrtimit kryesor të dt.01.02.2024 paditësja përmes përfaqësuesit të tij ka dorëzuar parashtresën për precizimin e padisë në aspektin objektiv, duke kërkuar nga e paditura kompensim dëmi material dhe jo material, ashtu që në emër të dhimbjeve fizike shumë prej 8,000€, për frikën e pësuar shumë prej 8,000€, për shëmtim trupor shumë prej 6,000€, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumë prej 13,000€, në emër të ndihmës dhe kujdesit të personit të tretë shumë prej 400€, në emër të ushqimit të përforcuar shumë prej 400€, në emër të rehabilitimit fiziatrigo – psikik shumë prej 7,000€, në emër të shpenzimeve të mjekimit shumë prej 716,80€, gjithsej në shumë prej 37,216.80 euro, me kamat 12% duke filluar nga dita e paraqitjes së kërkesës për kompensim, përkatësisht dt.28.02.2018 e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm, si dhe në emër të fitimit të humbur – rentës, ashtu që renta e arritur prej dt.07.01.2018 e deri më dt.31.01.2024 në shumë prej 12,356.07 euro dhe renta mujore duke filluar nga data 01.02.2024 e deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore në shumë prej 109,60euro, si dhe shpenzimet procedurale dhe atë në emër të përpilimit të padisë shumë prej 208€, emër të përfaqësimit në 5 seanca shumë prej nga 270€ (270x5=1,352€) dhe në emër të shpenzimeve për përpilimin e ekspertizës mjekësore shumë prej 300€, për ekspertizë të akuaristikës shumë prej 200€, për ekspertizën nga lëmia e punës shumë prej 150€, në shumë totale prej 2,458.00€. Ndërsa që në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbesin ne tërësi pranë deklarimeve të gjertanishme, ashtu që sa i përket bazës juridike e njëjta nuk është kontestuese ne mes te palëve ndërgjyqëse por vetëm lartësia e saj. Ka shtuar se në bazë të mendimeve të dhëna nga ekspertet ne këtë procedurë, të njëjtit kane konstatuar se paditësja ka lëndime të rënda trupore si dhe shëmtim trupor të shkallës se mesme me pasoja të përhershme. Ka theksuar se nga gjykata kërkojnë që me rastin e vendosjes të ketë parasysh se paditësja është e moshës se re, këtë zvogëlim të aktivitetit jetësor e ka të përhershëm, e sidomos të ketë parasysh shëmtimin e saj trupor sepse e njëjta është e gjinisë femërore dhe është e moshës se re. Precizimi i dorëzuar në

këtë seancë është ne harmoni të plotë me lëndimet që ka pësuar paditësja, si dhe me praktikën gjyqësore, andaj kanë kërkuar që i njëjti të aprovohet ne tërësi si i bazuar, e po ashtu kanë kërkuar që te aprovohet kamata prej 12% nga data 28.02.2018 kur është paraqitur kërkesa, kamata e cila është ne harmoni te plote me mendimin juridik te Gjykatës Supreme, sepse është shkelur neni 26 pika 2 LSDA-së, ku afati për përgjigje është brenda 3 ditësh, ndërsa e paditura ka kthyer përgjigje pas 2 muajve, po ashtu është shkelur neni 26 pika 4 i LSDA-së ku ne pamundësi për ta realizuar demin komplet është dashur te ipet pjesa jo kontestuese ne forme te paradhënies-avansit, e qe për kundër shumë kërkesave e paditura asnjëherë nuk e ka kryer këtë obligim ligjor deri me sot, po ashtu kanë kërkuar shpenzimet e procedurës dhe të përfaqësimit duke theksuar se te njëjtat ishin të domosdoshme ne këtë procedure dhe te njëjtat janë të bazuara në ligj.

E paditura B... me seli në Prishtinë përmes të autorizuarit të saj në përgjigjen në padi të paraqitur pranë kësaj gjykate, nëpërmjet të cilës e paditura nuk e ka kontestuar bazën juridike të kërkesëpadiisë, por e konteston lartësinë e shumës së kërkesëpadiisë të cilën e ka kërkuar paditësja. E njëjta gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se nuk kanë vërejtje në ekspertizën mjekësore te ekspertit M.H dhe nuk kërkojnë sqarime nga eksperti, e po ashtu nuk kanë vërejtje as sa i përket ekspertizës psikiatrike dhe nuk kanë kërkuar qe eksperti psikiatër te prezantoj në seancë për sqarime, ndërsa që e kanë kundërshtuar ekspertizës e punës, duke propozuar që lënda të dërgohet në Institutin e Mjekësisë Ligjore për të vërtetuar lidhjen kauzale në mes të lëndimeve të marra në aksident dhe pasojave të shkaktuara, e po ashtu e kanë kundërshtuar edhe nxjerrjen e ekspertizës financiare si të parakohshme. Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i të paditurës ka theksuar se qëndrojnë mbrapa përgjigjes në padi dhe deklarimeve në seancat gjyqësore, duke i propozuar gjykatës që të merr për bazë deklarimet e te paditurës me rastin e marrjes se vendimit meritor, si dhe gatishmërinë e te paditurës që kjo çështje të mbyllet me marrëveshje, duke theksuar se qëndrojnë pranë shumës prej 8.000 euro e cila është në proporcion me shkallën e lëndimeve të pësuar nga paditësja duke i propozuar gjykatës që përtej kësaj oferte pjesën tjetër ta refuzoj si të pa bazuar. Sa i përket kamatës, gjykatës i kanë propozuar që te vendoset prej momentit te nxjerrjes se aktgjykimit, mbështetur ne dispozitat ligjore dhe në mendimet e Gjykatës Supreme, ndërsa sa i përket shpenzimeve te procedurës gjykatës i kanë propozuar që të vendos në bazë të nenit 452 par.2 të LPK-së.

Procedura e provave dhe gjendja faktike e vërtetuar

Me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: raporti i aksidentit i dt.07.01.2018 se bashku me skicën e vendit te ngjarjes, fletë lëshimi me numër amze 46 ne emër te paditësës lëshuar nga QKUK- klinika e ortopedisë, kuponët fiskal si ne shkresat e lendes; dokumentacioni mjekësor ne shkresat e lendes ne emër te paditësës, ne baze te se cilit specifikacion janë nxjerr edhe ekspertizat mjekësore, kërkesa për paradhënie e paditësës e datës 28.02.2018 drejtuar te paditurës si dhe njoftimi nga e paditura i datës 06.04.2018, ekspertiza mjekësore e eksperteve mjekësorë M.H dhe B.O e dt 09.11.2023, deklarata e papunësisë ne emër te paditësës e dt 27.11.2023, pasqyra e trustit ne emër te paditësës e dt.22.11.2023, vërtetimi i lëshuar nga QPS ne emër te paditësës dt.27.11.2023, diploma për kryerjen e shkollës se mesme ne emër te paditurës, ekspertiza mjekësore nga lëmi i mjekësisë se punës e kryer nga A.A e datës 01.12.2023, ekspertiza aktuale e ekspertes G.Sh e datës 09.01.2024.

Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra, në kuptim të nenit 8 të Ligjit Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore (tutje referuar si: LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, dhe ka gjetur se kërkesëpadiia e paditësit është pjesërisht e bazuar, andaj gjykata ka vendosur si në dispozitiv të

këtij aktgjykimi.

Faktet e vërtetuara dhe vendosja në lidhje me pjesën e aprovuar:

Në mes palëve ndërgjyqëse, nuk ishte kontestuese baza e kërkesëpadisë, andaj edhe gjykata nuk ka nxjerrë prova për të konstatuar faktet jo kontestueses në mes të palëve.

Për të përcaktuar natyrën dhe shkallën e lëndimeve në këtë aksident trafiku dhe aftësinë e përhershme punuese të paditëses pas aksidentit në komunikacion, si dhe për të vërtetuar lartësinë e kërkesëpadisë, gjykata sipas propozimit të autorizuarit të paditëses, në cilësinë e provave materiale ka nxjerrë ekspertizën mjekësore nga eksperti psikiatër Dr.B.O, dhe ekspertizën mjekësor nga eksperti ortoped Dr. M.H, ekspertizën nga ekspertja e lëmisë së mjekësisë së punës Dr.A.A, si dhe ekspertizën me ekspert nga lëmia e aktuaristikës G.Sh.

Përmes raportit të ekspertit psikiatër u vërtetuan faktet si në vijim;

Se paditësja, nga aksidenti i komunikacionit të datës 07.01.2018, ka përjetuar frikë primare në kohëzgjatje prej disa sekondash, frikë sekondare të intensitet të lartë ka përjetuar për rreth dy orë, frikë sekondare të intensitetit të mesëm ka përjetuar ka përjetuar për rreth 4 muaj dhe frikë sekondare të intensitetit të ulët edhe tani, ku herë pas here te e njëjta paraqitet nervoz, paqëndrueshmëri emocionale e cila shkakton mërzi dhe pagjumësi në formë të zgjimeve të shpeshta natën dhe rikujtim të ngjarjes.

Përmes raportit të ekspertit ortoped-traumatolog, gjykata vërtetoi faktet si në vijim;

Paditësja në aksidentin e komunikacionit të datës 07.01.2018 ka pësuar thyerje të hapur me daljen jashtë të eshtrave në kondylin lateral të kockës së krahut të djathtë në pjesën që e formon nyjën e brrylit, gërvishtje në ballë dhe në fytyrë në anën e majtë. Ku lëndimet janë shkaktuar nga rënia, goditja në sipërfaqe të forte, si pasojë e aksidentit të trafikut dhe si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të rënda trupore, ku gjatë mjekimit dhe rehabilitimit e njëjta ka qëndruar në spital dhe është operuar dhe si rrjedhojë e këtyre lëndimeve, paditësja ka përjetuar dhimbje fizike me intensitet posaçërisht të rëndë në kohëzgjatje prej 60 minuta, dhimbje me intensitet të lartë 3 ditë, dhimbje me intensitet të mesëm 40 ditë dhe me intensitet të ulët ka edhe sot.

E njëjta ka shëmtim trupor në shkallë të mesme, për shkak të vrragave të mbetura 8 në pjesën e brrylit të djathtë, njëra me diameter 5-7 cm në formë të çrregulltë dhe 7 të tjerave me diameter 4-5 cm në pjesën anësore të brrylit të dukshme kohë pas kohe, sidomos në periudhat e ngrohta të motit ku paditësja ekspozohet me veshje të shkurta, duke marrë parasysh edhe moshën e re dhe gjininë e paditëses.

E njëjta ka zvogëlim të aktivitetit jetësor në shkallën 10%, për shkak të kufizimit të lëvizjeve – kontrakturës së nyjes së brrylit të djathtë për shkak të lëndimit të strukturave kockoro – ligamentoze, duke e krrahasuar me gjendjen e shëndoshë ku edhe pas operimit, mjekimit dhe rehabilitimit, konsiston në vështirësitë e paditëses që t'i kryej aktivitetet e mëparshme apo t'i kryej me aktivitet të shtuar të cilat I ka kryer para lëndimit pa vështirësi.

Gjithashtu, për paditësen ndihma nga personi tjetër ka qenë e nevojshme për 40 ditë e cila ka nënkuptuar ndihmë mjekësore profesionale dhe jo profesionale nga personat tjerë, e cila ndihmë i është ofruar personit të lënduar dhe i ka mundësuar plotësimin e nevojave biologjike siç janë: veshmbathja , higjiena personale, ushqimi, kryerja e nevojave të rregullta fiziologjike, kontrollet

sistematike, pasi këto nevoja nuk ka mundur ti plotësojë vetë si pasojë e paaftësisë fillimisht të plotë dhe pastaj të pjesshme e shkaktuar nga lëndimet trupore.

Lidhur me ushqimin e përforcuar, që ka qenë i nevojshëm për 40 ditë, e i cili ka nënkuptuar ushqim të pasur me proteina, minerale, vitamina, karbohidrate të nevojshme për ngjitjen dhe sanimin e lëndimit si dhe reaksionit post traumatik.

Dhe rehabilitimi fiziatrik në kohëzgjatje prej 30 ditë, i nevojshëm për përmirësimin e lëvizjeve në nyjat e bërrylit të djathtë, qafës si dhe rritjen e forcës dhe masës muskulore të dobësuar si pasojë e shtangimit të zhvilluar në nyje për shkak të pamundësisë së lëvizjeve në kohën e shërimit.

Përmes raportit të ekspertit nga lëmi i mjekësisë së punës, gjykata vërtetoi faktet si në vijim;

Në bazë të dokumentacionit mjekësor i cili gjendet në shkresat e lëndës dhe pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditëses, ekspertja e mjekësisë së punës ka vlerësuar aftësinë punuese të saj dhe ka konstatuar se nga data e aksidentit 07.01.2018, për shkak të lëndimit të rëndë trupor, 8 muajt e parë, paaftësia është e plotë në shkallën 100% për shkak të ekzaminimeve, intervenimeve dhe mjekimit intenziv, ndërsa 6 muaj tjerë 50%, për shkak të dëmtimeve, pasojave, mjekimeve të vazhdueshme dhe rehabilitimit. Nga data e ekzaminimit 30.11.2023, zvogëlimi i aftësisë së përhershme të punës është në shkallën prej 20%, duke theksuar se kjo përqindje epët për arsye se paditësja nuk punon tjetër punë përveç në amvisëri, punë shtëpiake ku kërkohet kapja, mbajtja dhe bartja e gjësendeve të ndryshme, si dhe peshave ku kërkohet sforcim fizik i të dy duarve në shumicën e punëve, ndërsa në rastin konkret për shkak të dëmtimeve që kanë ndodhur në dorën e djathtë dhe dëmtimit të disa funksioneve të kësaj dore si ekstenzioni i vështirësuar si dhe pronocioni dhe supinacioni të cilat ndikojnë në kryerjen e shumë punëve në amvisëri.

Përmes raportit të ekspertit nga lëmia e aktuarisitikës, gjykata vërtetoi faktet si në vijim;

Si rezultat i vërtetimit të gjendjes faktike për sa i përket zvogëlimit të aktivitetit punues përmes ekspertizës mjekësore, sipas propozimit të autorizuarit të paditëses, gjykata për të vërtetuar lartësinë e kompensimit që i referohet fitimit të humbur-rentës, ka caktuar nxjerrjen e provës me ekspertizë financiare të cilën e ka punuar G.Sh.

Ekspertja ka konstatuar se paditësja nuk është në marrëdhënie pune, një fakt i tillë është vërtetuar edhe përmes provave nga deklaratat e papunësisë ne emër te paditëses e dt 27.11.2023, si dhe pasqyra e trustit ne emër te paditëses e dt.22.11.2023. E po ashtu nga vërtetimi i lëshuar nga Qendra për Punë Sociale në Vushtrri e njëjta nuk është shfrytëzuese e ndihmës sociale dhe se paditësja ka qenë në kërkim të marrëdhënies së punës për të cilën tutje e kanë penguar pasojat e aksidentit. Ekspertja pasi që ka konstatuar se paditësja ka shkollën e mesme të kryer, e që edhe në shkresat e lëndës është e bashkëngjitur Diploma nr.04/357 që dëshmon se paditësja ka kualifikim të mesëm profesional në fushën e shëndetësisë si teknik i dhëmbëve, me rastin e llogaritjes së fitimit të saj të humbur, e ka përcaktuar pagën mesatare në rast se e njëjta nuk do të aksidentohej dhe do t'i ofrohej mundësia e punësimit në profesionin e saj , të ardhurat mujore për vitin 2020 arrijnë shumën prej 578.00euro, për vitin 2021 559.00 euro dhe për vitin 2022 548.00 euro e tutje, të ardhura këto të përafërta me tregun e lirë të punës në ordinancat private dhe publike për punonjësit që ushtrojnë profesionin e teknikut të dhëmbëve, dhe referuar nivelit të aftësisë punuese të zvogëluar prej 100%, 50 % dhe 20 %.. Në këtë mënyrë ekspertja ka llogaritur rentën mujore në proporcion me reduktimin e aftësisë punuese të paditëses për kryerjen e punëve të teknikut të dhëmbëve dhe rrjedhimisht ekspertja ka konstatuar se për periudhën e kaluar prej datës së aksidentit 07.01.2018 deri me 31.01.2024 shuma e gjithmbarshme e rentës

arrin në vlerë prej 12,356.07€. Kurse, për periudhën e ardhshme prej datës 01.02.2024 e në të ardhmen deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore, shumën prej 109.60€ në muaj. Po ashtu, eksperti ka kalkuluar rentën e kapitalizuar, e cila arrin në shumë prej 30,782.00€.

Gjykata, ekspertizat e ekspertëve mjekësor nga lëmia e psikiatrisë dhe ortopedisë, mjekësisë së punës dhe aktuaristikës, i ka pranuar në tërësi si të besueshme, me që të njëjtat ishin profesionale dhe të argumentuar, po ashtu të punuara sipas vëllimit të përcaktuar, duke ofruar të dhëna të arsyetuara lidhur me natyrën e lëndimeve dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve trupore, përkatësisht frikës së përjetuar si pasojë e aksidentit të trafikut, ekspertiza e ekspertes nga lëmia e mjekësisë në punë ishte me arsyetime të mjaftueshme lidhur me zvogëlimin apo vështirësitë në kryerjen e punëve sikurse para aksidentit, si dhe ekspertiza e ekspertes së aktuaristikës kishte të dhëna të arsyetuara lidhur me mënyrën e llogaritjes së rentës së arritur dhe asaj që duhet të rrjedhë muaj për muaj, e si rrjedhojë e kësaj, gjykata ua fali besimin e plotë me rastin e vendosjes se kësaj çështje juridiko-civile.

Mbi bazën e kësaj gjendje faktike gjykata konform nenit 159 par. 1 të LMD-së, në të cilin përcaktohet se “*1. Në rast aksidenti të shkaktuar nga mjeti motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat për përgjegjësinë në bazë të fajit*”, ndërsa në nenin 140 të këtij ligji, përcaktohet se: “*Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia*” dhe në nenin 136 të LMD-së, në të cilin përcaktohet se “*Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij*”, vlerësoi se e paditura mbanë përgjegjësi në bazë të fajit për dëmin që i është shkaktuar paditëses me rastin e lëndimit gjatë aksidentit të trafikut, për çka e paditura është e obliguar që paditëses t’ia kompensoi dëmin me që shkaktuesi i dëmit ka lidhur kontratë me të paditurën, dhe në këto rrethana kompensimin e dëmit e bën e paditura mbi bazën e sigurimit të auto përgjegjësisë TPL (Sigurimit të detyrueshëm për palët e treta) në pajtim me nenin 19 Ligji nr. 04/1-018 për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia ku përcaktohet se: Dëmshpërblimi nga mjeti motorik i pasiguar me regjistrim të huaj 1. Pala e dëmtuar të cilës i është shkaktuar dëm në territorin e Republikës së Kosovës nga një mjet motorik me regjistrim të huaj i pajisur me dokument ndërkombëtar të sigurimit, sipas nenit 16, të këtij ligji, ka të drejtë t’i parashtrojë kërkesë dëmshpërblimi Byrosë si dhe nenit 26 par 5 të këtij ligji ku përcaktohet se: Në rast se siguruari përgjegjës nuk i përgjigjet palës së dëmtuar brenda afateve të përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni, i dëmtuari ka të drejtë të ushtrojë padi në Gjykatën Kompetente.

Pas konstatimin të gjendjes faktike si më lartë, gjykata u lëshua në vlerësimin e lartësisë së kërkesëpadisë dhe atë lidhur me kërkesën që ka të bëjë me dëmin jo-material të paditëses, gjykata fillimisht mori për bazë dispozitën e nenit 183 par. 1 të LMD-së, përcaktohet se “***Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimin të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës***, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material”, dhe gjeti se gjendja faktike është në përputhje me gjendjen juridike si më lartë, andaj gjykata vlerëson se gjykimi i shumës në emër të dëmit jomaterial për paditësen dhe atë,

në emër të dhimbjeve fizike (trupore) shumën prej 4,000.00€, në emër të frikës së përjetuar për të gjitha kategoritë e saj shumën prej 4,000.00€, për zvogëlimin e aktivitetit jetësor në shkallën 10% shumën prej 4,000.00€, dhe për shëmtim trupor shumën prej 4,000.00 euro, duke pasur parasysh moshën e saj të re dhe gjininë, si dhe shëmtimin trupor të pësuar, i cili shëmtim është në shkallë të mesme, për shkak të 8 vrragave të mbetura në pjesën e bërrylit të djathtë, njëra me diameter 5-7 cm në formë të çrregulltë dhe 7 të tjerave me diameter 4-5 cm në pjesën anësore të

bërrylyt të dukshme kohë pas kohe, sidomos në periudhat e ngrohta të motit ku paditësja ekspozohet me veshje të shkurta, andaj mbi bazën e mësipërme, gjatë vlerësimit se lartësia e shumave në të holla në emër të kompensimit të dëmit jo material, do t'i mundësoj paditëses satisfaksion që ajo të jetë në gjendje që deri në një masë, t'i kompensoj të mirat jo materiale nga të cilat është privuar.

Sa i përket lartësisë së kërkesës për kompensimin e dëmit material, ndihma nga personi tjetër, ushqimi i përforcuar dhe shpenzimeve të mjekimit, gjykata pasi që nëpërmjet ekspertizave mjekësore konstatoj nevojën dhe kohëzgjatjen për ndihmë nga personi tjetër, dhe atë për 40 ditë të nevojës së kësaj ndihme, cila ka nënkuptuar ndihmë mjekësore profesionale dhe jo profesionale nga personat tjerë, e cila ndihmë i është ofruar personit të lënduar dhe i ka mundësuar plotësimin e nevojave biologjike siç janë: veshmbathja, higjiena personale, ushqimi, kryerja e nevojave të rregullta fiziologjike, kontrolle sistematike për të cilat ka pasur nevojë dhe nuk ka mundur ti plotësoj vet si pasojë e paaftësisë fillimisht të plotë e pastaj të pjesshme e shkaktuar nga lëndimet e pësuar në aksident, për çka edhe gjykata e ka aprovuar shumën prej 400.00 euro. Lidhur me ushqimin e përforcuar, që ka qenë i nevojshëm për 40 ditë, e i cili ka nënkuptuar ushqim të pasur me proteina, minerale, vitamina, karbohidrate të nevojshme për ngritjen dhe sanimin e lëndimit, si dhe reaksionit post traumatik për çka edhe gjykata e ka aprovuar shumën prej 400.00 euro.

Si dhe mbi bazën e dëftesëpagesës së dt.14.03.2018 dhe 02.05.2018, kuponëve fiskal të dt.05.03.2018, 18.03.2018, 02.03.2018, 07.03.2018, 11.02.2018, 23.01.2018 dhe 28.03.2018, i njohu paditëses shpenzimet e mjekimit në lartësi prej 82.70 euro, si dhe shpenzimet e rehabilitimit klimaterik në shumë prej 504.00 euro, i nevojshëm për 30 ditë, e i cili ka nënkuptuar përmirësimin e lëvizjeve në nyjën e byzylykut të dorës së djathtë, qafës, si dhe rritjen e forcës dhe masës muskulore të dobësuar si pasojë e shtangimit të zhvilluar në nyje për shkak të pamundësisë së lëvizjes në kohën e shërimit, çka edhe gjykata duke u bazuar në faturën me nr. 108815 të datës 04.07.2018, faturës me nr. 109024 e datës 07.07.2018, fletëpagesës nr.206222 së dt.09.07.2018 të lëshuara nga Termal Onix SPA Resort, si dhe faturave të dt.20.04.2018 dh 25.04.2018 të lëshuar nga Banja Nëna Naile, e po ashtu edhe në bazë të eksperizës mjekësore është konstatuar se të gjitha shpenzimet e prezantuara në shkresat e lëndës i përgjigjen nevojave për diagnostifikim, mjekim dhe rehabilitim.

Si rezultat i vërtetimit të gjendjes faktike për sa i përket zvogëlimit të aktivitetit punues, gjykata për të vërtetuar lartësinë e kompensimit që i referohet fitimit të humbur-rentës, u bazua në ekspertizën financiare të punuar nga ekspertja G.Sh, dhe vërtetoi se paditëses i është shkaktuar dëm material-fitim i humbur për periudhën e kaluar prej datës së aksidentit 07.01.2018 deri me 31.01.2024, ashtu që shuma e përgjithshme fitimit të humbur arrin në vlerë prej 12,356.07€. Kurse, emër të kompensimit për të ardhmen në formë të rentës mujore për 20% të zvogëlimit të aftësisë punuese, prej datës 01.02.2024 e derisa të ekzistojnë kushtet ligjore, ia ka caktuar shumën prej 109.60€ në muaj.

Lidhur me mënyrën e vendosjes që ka të bëjë me rentën, gjykata ka aplikuar dispozitën e nenit 172 par. 1 të LMD-së ku përcaktohet se: *“Në rast të vdekjes, të lëndimit trupor ose të dëmtimit të shëndetit, shpërblimi caktohet, sipas rregullës, në formë të rentës në të holla, për gjithë jetën ose për një kohë të caktuar”*. Gjukata vlerëson se për këtë kategori të dëmit rivendosja e gjendjes së mëparshme është e pa mundur, ngase paditësja ka humbur aftësinë punuese, në shkallën 20% për të ardhmen, prandaj shpërblimi i dëmit duhet të bëhet në formë të rentës në të holla. Kurse për pagesën e rentës mujore gjykata aplikoi nenin 172 par. 2, sipas të cilit: *“Renta në të holla e gjykuar në emër të shpërblimit të dëmit paguhet për çdo muaj përpara, në qoftë se gjykata nuk*

cakton diç tjetër”, e caktuar në shumë 109.60 euro në muaj, për çdo muaj e deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore, në përpjesëtim me shkallën e zvogëlimit të aftësisë punuese.

Gjykata vlerëson se shumat e kompensimit të aprovuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi që lidhen me dëmin material, janë adekuate, duke marr parasysh dëmin që i është shkaktuar paditëses dhe se lartësia e shumës së të hollave në emër të kompensimit, janë në përputhje me nenin 169 par. 3 të LMD-së ku thuhet se: *“Kur rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk është e mundur apo kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshme që këtë ta bëjë personi përgjegjës gjykata do të caktojë që ai t’ia paguajë të dëmtuarit shumën përkatëse në të holla në emër të shpërblimit të dëmit*”, e në lidhje me nenin 179 par. 1 të LMD-së, nga e cila dispozitë rrjedh se kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë që të shpërblej shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme lidhur me këtë, andaj gjykata me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit material, si dhe në lidhje me shumën kompensimit të këtij dëmi, gjeti se shuma si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, janë satisfaksion real për paditësit, si dhe mes tjerash gjykata ka pasur parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cili i shërben ky kompensim, e gjithashtu kriteret e vëna nga praktika gjyqësore.

Vendimi në lidhje me pjesën refuzuese të kërkesëpadisë, kamatën dhe shpenzimet e procedurës; Për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë që ndërlidhet më dëmin jo material në emër të dhimbjeve fizike, për frikën e pësuar për paditësen, gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që vlerësoi se kompensimi përtej shumës së gjykuar, gjegjësisht shuma mbi 4,000.00€ në emër të dhimbjeve fizike, shuma mbi 4,000.00€ në emër të frikës së përjetuar, shuma mbi 4,000.00€ në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe shuma mbi 4,000.00€ në emër të shëmtimit, nuk do të ishin në harmoni me të mirën e shkelur dhe me qëllimin të cilit i shërben ky shpërblim, ndërsa për kërkesat që ndërlidhen më dëmin material, gjykata ka refuzuar shumat mbi shumat e gjykuara si në dispozitiv, dhe atë në emër të rehabilitimit klimaterik ka refuzuar shumën mbi 504.00€, dhe në emër të shpenzimeve të mjekimit shumën mbi 82.70€, për shkak të mungesës së provave, megjithëse në shkresat e lëndës ishin të bashkangjitur disa kopje të kuponëve fiskal, mirëpo që të njëjtit ishin të palexueshëm për gjykatën.

Gjykata, paditëseve i njohu edhe kamatën në lartësi prej 12% në vit, ku afati për llogaritjen e kamatës fillon të rrjedhë që nga parashtrimi i kërkesës për kompensimin e dëmit me datë 31.07.2017, tek e paditura B... e deri në pagesën definitive, krejt kjo duke u bazua në nenin 26 të LSDA-së, dhe Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës për Kamatën, me numër 26/2020, i datës 02.12.2020, ngase përkundër që paditësja kanë parashtruar kërkesë tek e paditura për kompensimin e dëmit-shumës jokontestuese, e njëjta nuk iu ka ofruar ofertë për dëmshpërblim me shpjegime përkatëse, ndërsa që kërkesën e po të njëjtës datë për paradhënie e kanë refuzuar pa paraqitur arsye për një vendim të tillë.

Për shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi konform nenit 452 par. 1 të LPK-së, ngase paditësja ka fituar procesin kontestimor dhe e njëjta i ka kërkuar shpenzimet e procedurës, andaj gjykata të njëjtës ia njohu shpenzimet dhe atë në emër të përpilimit të padisë shumën prej 208€, në emër të përfaqësimit në 5 seanca shumën prej nga 270€ (270x5=1,352€) dhe në emër të shpenzimeve për përpilimin e ekspertizës mjekësore shumën prej 300€, për ekspertizë të akuaristikës shumën prej 200€, për ekspertizën nga lëmi i punës shumën prej 150€, në shumën totale prej 2,458.00€.

Andaj, gjykata duke u bazuar në faktet e përshkruara, provat e administruara dhe në bazë të nenit 143 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2019:229723
Datë: 14.02.2024
Numri i dokumentit: 05330534

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.127/2018, me datë 14.02.2024

Gj y q t a r i
Izet Gërguri

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është i lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimet të tij, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.